



Prishtinë, 13.06.2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1003\_2018

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 15 të Rregullores (EC) No 714/2009,
- Kërkesat nga takimet e grupeve punuese për energji elektrike në kuadër të ECRB që të bëhet transpozimi i Rregullës për transparencë 543/2013 të EC,
- Kërkesës së KOSTT për aprovimin e dokumentit Rregulla për Publikimin e të Dhënave të Tregut të Energjisë Elektrike,

**në seancën e mbajtur me datë 13.06.2018, nxori këtë:**

## V E N D I M

**I. APROVOHET “Rregulla për Publikimin e të Dhënave të Tregut të Energjisë Elektrike”.**

### Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 18.05.2018 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A. për aprovimin e dokumentit **Rregulla për Publikimin e të Dhënave të Tregut të Energjisë Elektrike**.
- Bazuar në kërkesat ligjore të sektorit të energjisë, si dhe kërkesave nga rregullorja 714/2009 e Komunitetit të Energjisë (KE), KOSTT ka përgatitë Rregullën për Publikimin e të Dhënave të Tregut të Energjisë Elektrike. ZRRE ka bashkëpunuar me KOSTT në përgatitjen e dokumentit përmes komenteve dhe diskutimeve gjatë përgatitjes të dokumentit. Dokumenti ka qenë në diskutim publik, dhe janë pranuar komente nga palët e interesuara të cilat janë shqyrtuar nga KOSTT dhe ZRRE.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të dokumentit të përgatitur nga KOSTT, ka vlerësuar se dokumenti është zhvilluar në harmoni me legjislacionin e sektorit të energjisë në Kosovë si



dhe me kërkesat nga Komuniteti i Energjisë, dhe përmes këtij vendimi ka **aprovuar** dokumentin “**Rregulla për Publikimin e të Dhënave të Tregut të Energjisë Elektrike**”.

**II.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

**III.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti. Dokumenti do të publikohet edhe në faqen elektronike zyrtare të KOSTT.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund ti drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejfiqaj, anëtar  
Selman Hoti, anëtar  
Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së.